

AKT THEMELIMI
I
Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“SANA”

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.1 Sot, më 01.10.2025 (Një Tetor Dymijë e Njëzetë e Pesë), ne, themeluesit, krijuam një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“SANA” SH.P.K.**

1.1. Themelues të shoqërisë janë:

1. Znj. **Aspasia Pandi**, shtetase greke, mbajtëse e pasaportës greke me Nr. **A00047513**.
2. Znj. **Marjana Veneti**, mbajtëse e dokumentit të identifikimit me Nr. Personal **G561220380**.
3. Z. **Orgest Hoxha**, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr. Personal **H80622230P**.

Neni 2

Objekti

2.1 Objekti i aktivitetit të shoqërisë, pa u kufizuar në të, do të jetë:

“Krijimi i një njësie lëvizëse të kujdesit shëndetësor parësor (shërbime ambulancash).Transporti dytësor me autoambulancë (transport jo urgjent i pacientëve) drejt spitalit, shtëpisë së të moshuarve apo qendrës së rehabilitimit. Mbulesa e aktiviteteve të ndryshme me autoambulanca, si ndeshje sportive, koncerte muzikore, aktivitete etj., ku sipas nevojave mund të jenë të pajisura edhe me mjekë reanimatorë për funksionimin e tyre si njësi të kujdesit intensiv. Transportet urgjente, si rol rezervë kur thirret nga shërbimet publike në raste emergjente. Ofrimi i kujdesit dhe ndihmës së menjëhershme mjekësore-farmaceutike (shërbime ndihme të menjëhershme vetëm me shoqërimin e mjekut), si dhe çdo veprimtari tjetër të ngjashme. Ofrimi i ndihmës në banesë, shërbime vizitash dhe kujdesi për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara,

kujdes ditor dhe aktivitete sociale mbështetëse. Tregtia e artikujve mjekësorë dhe ortopedikë, të konsumueshëm dhe jo të konsumueshëm. Tregtia dhe shpërndarja e pajisjeve mjekësore dhe të ngjashme. Tregtia e artikujve farmaceutikë dhe të ngjashme. Aktivitetet e kujdesit me ofrim akomodimi për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara. Aktivitetet e shërbimeve të akomodimit dhe ushqimit, si dhe administrimi i pasurive të paluajtshme. Aktivitetet e agjencive turistike, zyrave të udhëtimeve të organizuara dhe shërbimeve të rezervimeve, si dhe veprimtari të ngjashme”.

Neni 3 Kohëzgjatja

- 3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 99 vjet.

Neni 4: Selia

- 4.1 Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: “Lagjja “11 Janari”, rruga “11 Janari”, objekt 4-katësh, kati përdhe, pasuria me nr 4/19-N11, Zona Kadastrale 8541, Gjirokastrë”

KREU II KAPITALI

Neni 5 Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 3.000.000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:

1. **Znj. Aspasia Pandi**, zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.000.200 lekë që përben 33,34% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. **Znj. Marjana Veneti**, zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 999.900 lekë që përben 33.33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. **Z. Orgest Hoxha**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 999.900 lekë që përben 33.33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- 5.2 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6

Administrimi

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 1 vit, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 6.2 Personi e mëposhtëm caktohet si Administrator u parë të shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme:

Të dhënat e identifikimit:

1. Z. Orgest Hoxha, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr. Personal **H80622230P**.

Neni 7

Baza Ligjore

- 7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë Statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8

Mosmarrëveshjet

- 8.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhen nga Gjykata kompetente Shqiptare.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"SANA"



Pandi Aspasia
ORGEST HOXHA 




